



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

**“Supervizion punimesh Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi
Plepa”**

TIRANË 2023

I - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 4611/5, datë 27.06.2023, me lëndë “Transferim fondi për shpenzimet lokale”, është parashikuar të kryhet Supervizion i punimeve në objektin: **“Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa”**.

Për këtë i kërkohet Supervizorit të punimeve të kësaj Kontrate të kryejë mbikqyrjen e këtij objekti me fondin limit të mbikqyrjes së llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016: *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim , mbikqyrje dhe kolaudim “*.

II - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekt – zbatimi i objektit “Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa” është hartuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ky segment, pjesë e anashkalimit të Durrësit, është shumë i rëndësishëm pasi shërben për lidhjen e superstradës Tiranë – Durrës nga Nyja e Shkozetit deri në Mbikalimin e Plepave ku lidhet me rrugën Tiranë – Ndroq – Plepa dhe rrugën Plepa – Kavajë – Rrogozhinë.

Të gjitha mjetet e zonës së veriut që lëvizin drejt jugut dhe ato të Portit të Durrësit kalojnë në këtë segment rrugor.

Ky segment rrugor ku do të ndërhyet ka një gjatësi prej 4.2 km me dy karrexhata me trafikndarës tip new jersey, me gjerësi të shtresës asfaltike 7 m në të dy senset e lëvizjes.

Rruga kalon nëpër një zonë të dendur urbane dhe i nënshtrohet një trafiku të rënduar ku një pjesë të madhe e zë trafiku i mjeteve të rënda.

Shtresat asfaltike janë të dëmtuara me gropëzime, çedime, rrjetëzime etj.

Shtresa e asfaltotapetit është e konsumuar dhe e rrjetëzuar në të gjithë sipërfaqen dhe për të gjithë këtë gjatësi. Shtresa e binderit është e dëmtuar në pothuaj 30% të sipërfaqes së asfaltuar.

Paraprakisht, theksojmë se paketa e shtersave është ruajtur si ajo ekzistuesja, 4cm asfaltobeton dhe 6cm binder.

Ndërhyrja parashikon skarifikimin (frezimin) e të gjithë shtresës së tapetit dhe shtresën e binderit në rreth 30% të sipërfaqes. Gjithsesi pas heqjes së shtresës së tapetit do të përcaktohet saktë sipërfaqja dhe thellësia e saktë e ndërhyrjes në shtresën e binderit dhe nënshtresat e tjera. Pas frezimit do të vazhdohet me profilimin e shtresës së binderit me trashësi 6cm dhe asfaltimin e shtresës së tapetit me trashësi 4cm.

Më tej sinjalistika horizontale e vijëzimit gjatësor me gjerësi 15cm dhe shenjave të trafikut do të bëhet me bojë termoplastike sprajt. Sinjalistika vetrikale do të jetë si plotësim i asaj ekzistuese.

Organizimi i punimeve

Planin i organizimit të punimeve dhe menaxhimit të trafikut do të jetë i ndryshueshëm sipas përparimit të punimeve që do të thotë që rrugët alternative për devijimin e trafikut do të ndryshojnë në vazhdimësi deri në përfundimin e punimeve. Ai do të përgatitet nga kontraktori në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe do të miratohet nga Autoriteti Kontraktor në Bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë.

Siguria rrugore

Meqënëse jemi duke punuar në një nga arteriet më të rëndësishme, me qarkullim të madh të mjeteve të rënda siguria rrugore merr një rëndësi të vecantë. Sipërmarrësi duhet të sigurojë lëvizjen e mjeteve në rrugën automobilistike. Në rrugë do të vendoset sinjalitika e punimeve në rrugë, e cila do të jetë me ndriçim për tu bërë e dallueshme natën.



Tabelat që tregojnë punime në rrugë dhe uljen e shpejtësisë do të vendosen në të dy anët e lëvizjes në distancë që të lejojë mjetet të marrin masa përpara se të arrijnë në vendin ku punohet. Tabelat e shpejtësisë (vendosen disa tabela njëra paralajmëruese si dhe shirit tregues.

III- OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikqyrësi i punimeve ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e të gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti dhe anën ekonomike të tij (vlefte e kontratës).

IV- DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit: *“Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa”*, mbikqyrësi menjëhere mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998, të ndryshuar ,VKM Nr.3 dt.15-02 2001, VKM Nr.1 dt. 22.02.2005, VKM Nr 2 dt.13.5.2005 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.
- Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit.
- Të njihet në detja me planin e menaxhimit të trafikut të përgatitur nga kontraktori, të japë pëlqimin për të dhe ta përcjell për miratim pranë organeve kompetente.
- Të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.
- Të paraqesë pranë ARSH-së stafin e tij mbikëqyrës.

Shënim:

- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlefës së kontratës, drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesshme në funksion të specifikave të punës.
- Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktori me ARSh-në, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të tjera, etj.
- Mbikqyrësi vihet në dijeni nga ARSh-ja për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar dhe miratuar nga ana e tij (investitori).
- Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe informon për personat kryesor përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti në përputhje me nenin 9 të ligjit Nr.8402,dt 10.09.1998

Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të liçencave, të autorizimeve



dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.

- Të bëj verifikimin e sheshit të ndërtimit nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet mirë me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe të njohë të gjitha ndryshimet e mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrolloj vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit më këto të dhëna:
 - Emërtimi i objektit: **“Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa”**.
 - Investitori: Autoriteti Rrugor Shqiptar
 - Projektuesi: “ _____ ”
 - Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik: “ _____ ” sh.p.k
 - Mbikqyrësi: “ _____ ”
 - Afati i ndërtimit të objektit: ___ Muaj

Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së Kontratës duhet :

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabetave përkatëse sinjalizuese, treguese të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë ARrSh-së të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
 - Staf i Sipërmarrësit,
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
- Para fillimit të punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe ti rekomandojë ARrSh-së zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit.
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
- Në çdo fund ditë pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë.
- Të kontrollojë librin e masave i cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratoj atë.
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre.



- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë ARRSH - së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARRSH -ja.
- Në çdo fund muaji mbikqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë ARRSH -së raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë dhe % , afati kohor i realizimit të financimit.

Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:

- Hyrje.
- Informacion i përgjithshëm.
 - Të përgjithshme.
 - Qëllimi i punimeve.
 - Mbikqyrja e punimeve ndërtimore.
- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi.
 - Staf i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve .
 - Staf aktual.
 - Kohqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi.
- Kohzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes.
- Përshkrimi i Projektit.
 - Shtresat Rrugore.
 - Veprat e Artit etj.
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - Sipërmarrësi.
 - Staf i prezent.
 - Mjete dhe makineri.
 - Kohqëndrimi në objekt.
- Progresi Mujor.
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave).
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera.
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm.
- Grafiku i ecurisë së punimeve:
 - Të aprovuara.
 - Të kryera.
- Volumet Progressive të Punimeve Mujore:
 - Punimet e aprovuara.
 - Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike.



- Libreza e Masave.
- Punimet e kryera por të pa aprovuara.
- Situacionet mujore.
- Matjet topografike.
- Korrespondenca:
 - Proces-Verbale.
 - Urdhëra, udhëzime, njoftime.
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga ARRSH-ja).
- Moti (kalendarik).
- Problemet që kanë dalë:
 - Teknike.
 - Sociale.
- Konkluzione.

Shënim :

- Raporti Mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në ARRSH pranë Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirmbajtjes, Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme, si dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Sektorit të Shpronësimeve.
- Raporti Mujor do t'i dorëzohet ARRSH-së brenda datës së caktuar në kontratë.
- Mbikqyrësi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me ARRSH-në (Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirmbajtjes, Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme, si dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Sektorit të Hartimit të Projekteve të Brendshme) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikqyrësi mban përgjegjësi të plotë.

Në fillim të punimeve, Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vërtetësisë së dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe ARRSH-së dhe të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të koston së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikqyrësit.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Sektorin e Menaxhimit të Projekteve të Brendshme, dhe Sektorin e Shpronësimeve, urdhërat e ndryshme që ai ka



dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të mbikqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

Mbikqyrësi ka të drejtë :

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të vecantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësoj ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore.
- Të mos lejoj përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi, këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
- Kur Mbikqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.
- Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
- Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e ARRSH-së për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, Mbikëqyrësi së bashku me ARRSH-në dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht ARRSH-së për gjendjen e tij.
- Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402, dt 10.09.1998, VKM Nr. 2 datë 13.5.2005 dhe VKM Nr. 3 datë 15.02.2001, dorëzon pranë ARRSH-së (Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Dorëzimit) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin , saktësinë, vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë :

- Proces-verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proces-verbal për fillimin e punimeve.
- Kontratën e sipërmarrësit.
- Kontratën e mbikëqyrjes.
- Projekt organizimi i punimeve.
- Projektin.
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
- Preventivin fitues.
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negocimin e tyre).
- Grafiku i punimeve.
- Specifikimet teknike.
- Axbornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi.
- Dokumentacioni topografik dhe gjeologjor inxhinjistik për ndërtim rrëshqitje.
- Dokumentacioni fotografik apo video regjistruar për punimet e padukshme.
- Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi, të shoqëruar me fotografi.
- Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
- Libreza e masave.
- Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proces-verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
- Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
- Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
- Çertifikatat e cilësisë së materialeve.
- Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi.
- Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
- Regjistri i kontabilitetit.
- Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
- Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.



- Proces-verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
- Relacioni përfundimtar i mbikëqyrësit.

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga ARRSH -ja brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që i dorëzohen Grupit të Kolaudimit pranë ARRSH -së duhet të jenë origjinale.

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit i cili i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar ARRSH-së.

V - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

Do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

VI - TË DREJTAT E ARRSH-së.

ARRSH-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet. Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, ARRSH-ja ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr. 8402 dt. 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

VII - MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS.

Oferta jepet në vlef të totale e zbërthyer në shpenzime për muaj - njeri (sipas preventivit bashkëngjitur) dhe shpenzime të tjera të nevojshme për tu kryer.

VIII - MËNYRA E PAGESËS.

Pagesa do të bëhet mujore në bazë të % së realizimit të punimeve të zbatimit e zbërthyer sipas shpenzimeve në muaj për njeri.



PREVENTIV
MBIKQYRJE PUNIMESH

Objekti: *“Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa”*.

Kodi	Emërtimi	Njësia	SHPENZIMET		
			Sasia	Çmimi	Vlefte
	Stafi				
1	Drejtor projekti	Staf - muaj	(100%)		
2	Inxhinier topograf	Staf - muaj	(100%)		
3	Inxhinier për sigurinë rrugore	Staf - muaj	(50%)		
4	Inxhinier mjedisi	Staf - muaj	(15%)		
	Shuma 1				
	Shpenzime				
	Shpenzime të ndryshme	Lump sum			
	Paisje , maeriale etj	Lump sum			
	Shuma 2				
TOTALI					



MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

DUKE JU REFERUAR VKM 354 DT.11.05.2016 LLOGARITJA E FONDIT LIMIT ESHTË BERE SI ME POSHTE VIJON.

VLERA E NDERTIMIT PA TVSH 124,959,682.40 LEK

VLERA E NDERTIMIT ME TVSH 149,951,618.88 LEK

VLERA MAKSIMALE PËR MBIKQYRJEN PA TVSH 1,346,516.84 LEK

VLERA MAKSIMALE PËR MBIKQYRJEN ME TVSH 1,615,820.21 LEK

1. STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QRKULLIMIT **GRUPI "II" TARIFOR**
2. SHERBIMI I TOPOGRAFISE PER FAZEN E NDERTIMIT PER STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT **GRUPI "II" TARIFOR**

